



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 430 Akti

Nr. 266 Vendimi  
Tiranë, më 18.6.2020

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bektashi</b>	Kryesuese
<b>Firdes Shuli</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Anisa Duka, mori në shqyrtim në mënyrë qarkulluese nëpërmjet komunikimit elektronik me vëzhguesen ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga Covid-19, të shpallur me vendim nr. 243 datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave dhe masave të ndërmarra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në drejtim të kufizimeve të veprimtarisë, në datën 18.6.2020, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ndue Gjura**, me funksion inspektor pranë ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (sot, Këshilli i Lartë Gjyqësor).

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

**Vendimi nr.78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

## I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ndue Gjura, gjatë periudhës së fillimit të rivlerësimit kalimtar ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar si inspektor pranë ish-KLD-së (sot, KLGJ). Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ndue Gjura, është shortuar si subjekt rivlerësi në shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”. Nga procedura e shortit rezultoi se procesi i rivlerësimit do të kryhet nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes me short u zgjodh komisionere Firdes Shuli.

3. Me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

4. Në datën 10.1.2020, subjekti u njoftua nëpërmjet postës elektronike, mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, përbërjen e trupit gjykues, si dhe iu kërkua të shprehej nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

5. Në datën 27.1.2020, subjekti i rivlerësimit, njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se: (i) nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me asnjërin nga anëtarët e trupit gjykues; (ii) në datën 8.1.2020 i kishte paraqitur KLGJ-së dorëheqjen nga detyra duke kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit; (iii) me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.1.2020, KLGJ-ja kishte vendosur “mbarimin e statusit të magjistratit Ndue Gjura”.

6. Me shkresën “*njoftim mbi dorëheqjen dhe mbarimin e statusit të magjistratit*”, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2020, subjekti i rivlerësimit vuri në dispozicion të Komisionit: (i) kërkesën për heqjen dorë nga detyra të datës 8.1.2020, protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2020, në KLGJ; (ii) dhe kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 23.1.2020, të KLGJ-së.

7. Me shkresën “*njoftim vendimi*” nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020, të KLGJ-së: (i) njoftoi miratimin e kërkesës për dorëheqje të subjektit Ndue Gjura, duke deklaruar mbarimin e statusit të tij si magjistrat, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor; (ii) vuri në dispozicion të Komisionit vendimin nr. \*\*\*, datë 23.1.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Ndue Gjura, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.1.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: (i) të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Ndue Gjura, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë KLGJ-së, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status; (ii) efektet e këtij urdhërimi fillojnë në datën 15.2.2020; (iii) një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit Ndue Gjura sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen

zyrtare të internetit të KLGJ-së; (iv) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

## **II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

### **a. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

9. Kolegji i Posaçëm i Apelimit në lidhje me praktikat e gjyqimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: (i) Presidenti i Republikës; (ii) Këshilli i Lartë Gjyqësor; dhe (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

10. Si detyrim kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

### **b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje**

11. Subjekti i rivlerësimit vuri në dispozicion të Komisionit<sup>1</sup> kërkesën për heqjen dorë nga detyra të datës 8.1.2020, protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2020, në KLGJ, si dhe kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 23.1.2020, të KLGJ-së.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në kërkesën për dorëheqje të subjektit Ndue Gjura, ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor). Për këtë vendim krahas Komisionit është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit, z. Ndue Gjura.

13. Për sa më sipër, Komisioni vëren se konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi z. Ndue Gjura ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit.

14. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim<sup>2</sup> ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 23.1.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor .

### **c. Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

15. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t'u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në rrugë elektronike, në datën 30.4.2020, i bëri me dije subjektit të rivlerësimit, z. Ndue Gjura, se gëzon të drejtën për t'u dëgjuar nga Komisioni në seancë dëgjimore dhe në rast të kundërt procesi i rivlerësimit ndaj tij do të ndërpritej pa seancë dëgjimore, duke i kërkuar të shprehet për sa më sipër.

---

<sup>1</sup> Shihni shkresën “njoftim mbi dorëheqjen dhe mbarimin e statusit të magjistratit”, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2020.

<sup>2</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\*prot., datë 21.2.2020, nga Gjykata Administrative e Apelit, në dosjen e Komisionit.

16. Pas dërgimit të njoftimit në lidhje me respektimin nga Komisioni të së drejtës së tij për t'u dëgjuar, subjekti i rivlerësimit, z. Ndue Gjura, nëpërmjet komunikimi elektronik të së njëjtës datë, 30.4.2020, shprehu qëndrimin e tij se nuk dëshironte të dëgjohej në seancë dëgjimore.

#### **d. Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit**

17. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

18 Trupi gjykues konstaton se z. Ndue Gjura, ka qenë me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë KLD-së (sot, KLGj), duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

19. Në germën "a", pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

20. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon: "*1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.*"

21. Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: "*1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*".

22. Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon: "*1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit, ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit*".

23. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: "*[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit*

*të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*

24. Me paraqitjen e kërkesës nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, z. Ndue Gjura “nga funksionet e magjistratit” dhe të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e këtij statusi në datën 23.1.2020.

25. Në lidhje me të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore publike, në zbatim të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit deklaroi mosushttrimin e kësaj të drejte, duke kërkuar njëkohësisht ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

26. Për sa më sipër, në referim të gremës “b”, të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit u njoftua në lidhje me të drejtën e tij për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, deklaroi mosushttrimin e kësaj të drejte dhe, konfirmoi kërkesën për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se procedura administrative për këtë subjekt duhet të mbyllet pa qenë e nevojshme zhvillimi i seancës dëgjimore.

Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G”, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ndue Gjura.
2. Ndalimin e emërimit të z. Ndue Gjura si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim, u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 18.6.2020.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
Kryesuese

**Suela ZHEGU**  
Anëtare

**Firdes SHULI**  
Relatore

*Anisa Duka*  
Sekretare Gjyqësore